



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1057 prot.

Tiranë, më 18. 09. 2018

Lënda: Rekomandohet marrja e masave në lidhje me çështjen e strehimit të komunitetit rom dhe egjiptian, në zonën e Selitës, Tiranë.

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

BASHKISË SË TIRANËS

Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Tiranë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka marrë dijeni për shqetësimin e një grupi familjesh të komunitetit romë dhe egjiptian, banesat e të cilëve u prekën nga ndërtimi i unazës së madhe në zonën e Selitës, Tiranë.

Këto familje u trajtuan me qira 3 vjeçare në bazë të VKM-së nr. 230, datë 13.03.2015 “*Për trajimin me pagesë të qirave për disa familje që preken nga zbatimi i projektit: Unaza e Madhe e Tiranes, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës*”, të ndryshuar¹. Afati i trajtimit me qira sipas VKM nr. 230, datë 13.03.2015, të ndryshuar, ka përfunduar në mars 2018.

¹ Ndryshuar me: VKM Nr. 694, datë 29.07.2015; VKM Nr. 314, datë 27.04.2016; VKM Nr. 552, datë 27.07.2016; VKM Nr. 261, datë 29.03.2017.

Përfaqësuesit e këtyre familjeve shpjegojnë se kanë ndërmarrë iniciativën për të përfituar nga programi social i strehimit, sipas ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “*Për programet sociale të strehimit*”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, por të gjendur përpallë vështirësive dhe pengesave objektive për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm, në mbledhjen e datës 07.06.2018, Këshilli Bashkiak Tiranë, vendosi trajtimin me bonus strehimi vetëm për 15 familje, nga 33 familje në total të cilat kishin aplikuar. Ndërkohë, shpjegohet se, 18 familjet e tjera që kishin aplikuar nuk arritën të përfitonin nga ky program për shkak të mungesave në dokumentacion. 18 familjet e skualifikuara kanë dorëzuar sërisht dokumentacionin e plotë dhe të rinouar pranë Bashkisë së Tiranës, por deri në muajin shtator 2018, periudhë në të cilën sipas informacionit që iu është dhënë këtyre familjeve, mund të mblidhet Këshilli Bashkiak i Tiranës, dokumentacioni administrativ i kërkuar sipas nevojës duhet të rinojitet.

Gjithashtu, përfaqësuesit e këtyre familjeve shpjegojnë se, për familjet në Vlorë të cilat u prekën nga zbatimi i projektit “*Lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier – Vlorë*” do të vijojë trajtimi me pagesë qirave në bazë të VKM-së nr. 254, datë 09.05.2018 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 58, datë 21.01.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin e disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”, me programe sociale të strehimit*”, të ndryshuar. Ata pretendojnë se situata e tyre është e njëjtë me atë të familjeve të Vlorës, pasi në të dyja rastet banesat e tyre u përjashtuan nga procesi i legalizimit për shkak të një investimi publik dhe me prishjen e banesave (në Selitë dhe në Vlorë), të dyja kategoritë u trajtuam me pagesë qiraje 3 vjeçare nga buxheti i shtetit. Pra, edhe pse në situatë të njëjtë, ata pretendojnë se po trajtohen në mënyrë më pak të favorshme, pasi ndryshe nga familjet në Vlorë të cilët në bazë të VKM 254, datë 09.05.2018 do të vazhdojnë të trajtohen me qira nga buxheti i shtetit, një një e tillë nuk është bërë për familjet rome dhe egjiptiane në Selitë. Ky trajtim ndryshtet, nuk është i përligjur, dhe duke marrë në konsideratë kushtet e vështira social-ekonomike, i vendos në pozita diskriminuese për sa i përket çështjes së strehimit.

Të ndodhur në kushte të vështira social-ekonomike, përfaqësuesit e këtyre familje kërkojnë marrjen e masave për zgjatjen e afatit të trajtimit me pagesë qiraje, sipas VKM-së nr. 230, datë 13.03.2015, për familjet e komunitetit rom dhe egjiptian të zonës së Selitës, Tiranë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar çështjen e strehimit të familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian në zonën e Selitës, Tiranë, të cilët u trajtuan me qira të financuar nga shteti në bazë të VKM nr. 230, datë 13.03.2015 “*Për trajtimin me pagesë të qirave për disa familje që preken nga zbatimi i projektit: Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruja e Kavajës*”, të ndryshuar. Me vendimin nr. 114, datë 22.06.2016, Komisioneri ka konstatuar diskriminimin e tërthortë, për shkak të racës, të shtetasve që i përkasin komunitetin Rom dhe Egjiptian të zonës së Selitës në Tiranë që u preken nga ndërtimi i “*Unazës së Madhe e*

Tiranës, segmenti, Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës”, pasi ky vendim edhe pse i paanshëm në dukje, i vendos familjet që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian në kushte jo të favorshme.

Këshilli i Ministrave, nëpërmjet VKM nr. 230, datë 13.03.2015 “*Për trajtimin me pagesë të qirave për disa familje që preken nga zbatimi i projektit: Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës*”, tës ndryshuar, ka vendsur të trajtojë me qira të gjitha familjet që prekeshin nga zbatimi i projektit të unazës së madhe, *duke mos bërë diferencime në trajtim për familjet e komunitetit rom dhe egjiptian, që janë dukshëm në kushte më të këqija sociale dhe ekonomike krahasuar me familjet e tjera. Në vendimin e tij Komisioneri ka theksuar faktin se*, nëse autoritetet shtetërore përpara se të ndërmarrin veprime për largimin e familjeve rome nga banesat e tyre, *nuk bëjnë paraprakisht një analizë dhe vlerësim të gjendjes sociale, nevojave ekonomike të këtyre familjeve*, dhe nuk marrin të gjitha masat e nevojshme (në maksimumin e burimeve që janë në dispozicion), për të evituar që këta individë të mbeten të pastrehë apo të bëhen vulnerabël ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut, përbën diskriminimin.

Me vendimin e tij nr. 114, datë 22.06.2016, me qëllim rregullimin e situatës dhe për të parandaluar pikërisht situatën e krijuar, ku këto familje kanë mbetur pa një strehim të qëndrueshëm, Komisioneri, i ka rekomanduar Këshillit të Ministrave, të marri masa për sigurimin e strehimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian që janë trajtuar me pagesë të qirave, përpara mbarimit të afatit të VKM-së nr. 230, datë 13.03.2015.

- Legjislacioni i brendshëm dhe e drejta ndërkombëtare

Çështja e mosdiskriminimit në fushën e strehimit e trajtuar në nenin 20 të ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” duhet të trajtohet duke bërë një ndërthurje të parashikimeve që bëhen nga normat juridike kombëtare në raport me parashikimet dhe standartet ndërkombëtare në këtë fushë, standarte të cilat vendi ynë ka pranuar të zbatojë duke nënshkruar dhe ratifikuar aktet ndërkombëtare, në kuadër të OKB-së, Këshillit të Evropës dhe procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit të integrimit të vendit tonë në BE.

Legjislacioni ynë kombëtar dhe **Kushtetuta** si akti më i lartë në hierarkinë e normave juridike, nuk parashikon një të drejtë të përgjithshme për strehim, në kuptimin që shteti është i detyruar në terma absolute për ta realizuar këtë të drejtë. Megjithatë, në interpretim të nenit 116 dhe 122 të Kushtetutës, **traktatet ndërkombëtare të ratifikuara** janë të vetëzbatueshme dhe pjesë rregullimit ligjor shqiptar. Kjo çështje duhet interpretuar gjithashtu në përputhje me nenin 17 të kushtetutës dhe të drejtën për jetë private dhe familjare sipas **Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)**.

E drejta ndërkombëtare e njeh të drejtën për strehim të përshtatshëm si pjesë përbërëse thelbësore të një standarti të përshtatshëm jetese. *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*, në nenin 25 paragrafi 1, parashikon të drejtën e çdokujt për një standart të përshtatshëm jetese, përfshi të drejtën për një strehim të përshtatshëm. Neni 11 paragrafi 1 i *Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe 'Kulturore* deklaron se çdokush ka të drejtë për një standart të përshtatshëm jetese për veten dhe familjen e tij, përfshi, ushqim, veshëmbathje dhe strehim të përshtatshëm dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës. *Konventa Ndërkombëtare për Eleminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor* (neni 5e/iii) e ndalon diskriminim racor për gjëzimin e të drejtës për strehim.

Në *Komentin e tij të Përgjithshëm nr.4* për të drejtën për një strehim të përshtatshëm, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore², struktura e Kombeve të Bashkuara e krijuar për monitorimin e zbatimit të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, shprehet se, e drejta për strehim nuk duhet barazuar me pasjen e një çatie mbi kokë, por ajo duhet parë si e drejtë për të jetuar diku në siguri, paqe dhe dinjitet. Komiteti për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore, thekson gjithashtu se e drejta për strehim u duhet garantuar të gjithë personave, pavarësisht të ardhurave të tyre, dhe duhet zbatuar në një mënyrë të tillë që të përputhet me mundësitet e tyre.

Sipas *parimeve dhe udhëzimet bazë të Kombeve të Bashkuara dhe Udhëzimet për Lirimet bazuar mbi Zhvillimet dhe mbi Zhvendosjen*³, është detyrim që liri i banesës të mos i kthejë individët në të pastrehë, vulnerabël ndaj shkeljes së të drejtave të tyre të tjera.

Po sipas këtyre parimeve, kërkohet që: të ndërmerren vlerësime mbi ndikimin që mund të kenë investimet që realizohen kuadër të zhvillimit, dhe që këto vlerësime duhet të marrin parasysh ndikimet e ndryshme që dëbimet kanë mbi gratë, fëmijët, të moshuarit dhe grupet e marginalizuar të shoqërisë.

Sipas *Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*, shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që të garantojnë se grupeve vulnerabël si Romëve/udhëtarëve u duhen ofruar mundësi të përshtatshme për të rregulluar strehimin e tyre dhe mos marrja në konsideratë e nivelit të tyre të mohimit përgjatë viteve ku hartohen kërkuesat e nevojshme për rregullimin e strehimit mund të çojë në diskriminim të tërthortë.

Konsiderata të ngjashme, gjenden edhe në *Kartën Sociale Evropiane të Rishikuar* apo në dokumentat e Komitetit Evropian për të Drejtat Sociale, organ i ngarkur me mbikqyrjen e

² CESCR General Comment No. 4: The Right to Adequate Housing (Art. 11 (1) of the Covenant)

³ Basic Principles and Guidelines on Development-Based Evictions and Displacement, Annex 1 of the Report of the Special Rapporteur on Adequate Housing as a Component of the Right to an Adequate Standard of Living A/Hrc/4/18

zbatimit të Kartës. E drejta për strehim mbrohet nga tre nene të instrumentave (neni 16 – i cili është i njëjtë për të dyja versionet e Kartës⁴ dhe gjithashtu nenii 31 i Kartës Sociale Europiane e Rishikuar)⁵, e cila në lidhje me të drejtën e strehimit parashikon të njëjtën përbajtje dhe të njëjtat detyrime për shtetet anëtare.

Shqipëria nuk ka ratifikuar nenet që parashikojnë detyrimet e mësipërme, por Shqipëria zbaton vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, dhe kjo e fundit i referohet vazhdimeshit punës së Komitetit Evropian për të Drejtat Sociale (KEDS) për udhëzime dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të Konventës Evropiane, duke përfshirë edhe ato dispozita të cilat nuk janë miratuar nga vendet anëtare.

Të gjitha parimet e parashikuara nga Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale reflektohen gjithashtu edhe në *Rekomandimet e Komitetit të Këshillit të Evropës*. Kështu, Komiteti i Këshillit të Evropës ka nxjerrë rekomandime në këtë drejtim dhe konkretisht Rekomandimi (2005)⁴ *Për Përmirësimin e Kushteve të Strehimit të Romëve dhe Udhëtarëve në Europë*, miratuar më 23 shkurt 2005. Sipas këtij rekomandimi, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës u kërkon shteteve anëtare, që meqenëse romët⁶, vazhdojnë të mbeten ndër grupet më shumë të disavantazhuara në Evropë, politikat kombëtare të strehimit duhet të adresojnë problemet e tyre specifike si çështje emergjence dhe në mënyrë jodiskriminuese.

Edhe *Direktiva e BE-së* për Barazinë Racore⁷ nuk e përkufizon të drejtën për strehim të përshtatshëm, por ndalon diskriminimin për shkak të racës dhe përkatësisë etnike duke përfshirë edhe strehimin. Direktiva orienton që interpretimi i saj të bëhet sipas të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, traktateve të Kombeve të Bashkuara dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), i ka trajtuar çështjet e strehimit në kuadër të nenit 8 të Konvëntës. GJEDNJ-ja, e ka interpretuar nenin 8 të KEDNJ se përfshin çështje që lidhen me veprimitari të cilat kanë pasojë për jetën private, përfshi marrëdhëniet e një karakteri ekonomik dhe shoqëror.

⁴ Karta Sociale Europiane dhe Karta Sociale Europiane e Rishikuar, nenii 16 “E drejta e mbrojtjes sociale, ligjore dhe ekonomike e familjes. Me qëllim që të sigurojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin e plotë të familjes, e cila është bërthama themelore e shoqërisë, Palët Kontraktuese marrin përsipër të nxisin mbrojtjen e jetës familjare ekonomike dhe sociale me anë të mjeteve të tillë si përfitimet sociale dhe familjare, marrëveshjet fiskale, ofrimin e strehimit familjar, përfitime për të sapo martuarit dhe mjete të tjera të përshtashtme.”

⁵ Neni 31 i Kartës Sociale Evropiane parashikon si më poshtë: “Të drejtën e strehimit. Me qëllim që të garantojë zbatim efektiv të së drejtës për strehim, palët marrin përsipër masa të cilat: -nxisin aksesin tek strehimi i një standardi të përshtatshëm; -nxisin dhe zgjedhjet e mosstrehimin me qëllim eleminimin e plotë të tij; -ofrimin e çmimive të shtëpisë që janë të përballueshme për ata që nuk kanë mjetet e përshtatshme.”

⁶ Në rekomandim sqarohet se termi “Rom” i përdorur në këtë tekstu i referohet romëve/ciganëve dhe komuniteteve të udhëtarëve dhe duhet të interpretohet se mbulon në mënyrë të gjerë diversitetin e këtyre grupeve.

⁷ Direktiva e Këshillit 2004/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”.

Liqj Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, ka sjellë ndryshime të rëndësishme në drejtim të vendosjes së procedurave që duhen ndjekur në rastet e zhvendosjeve në rastet e investimeve për një interes publik, konceptet e strehimit të përshtatshëm dhe respektimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve që preken, në mënyrë të shprehur ky liqj ndalon dëbimin e individëve nga vendbanimi i tyre. Ky liqj edhe pse nuk ka hyrë ende në fuqi, për garancitë shtesë që ofron dhe ndalimin e dëbimeve, përbën një hap ‘pozitiv. Fryma që ka sjellë Ligji Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” duhet të udhëheqë edhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave aktuale të strehimit, duke synuar kështu minimizimin e mangësive dhe problematikave të legjislacionit të vjetër, të cilat ky liqj ka synuar të eleminojë.

- **Masat pozitive, masat e veçanta**

Termi “**mos-diskriminim**” nuk nënkupton nevojën e trajtimit uniform kur ka ndryshime të rëndësishme në gjendje ndërmjet një personi apo grupei me një tjetër, ose me fjalë të tjera, nëse ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e diferencuar. Të trajtosh në një mënyrë të barabartë persona ose grupe situatat apo gjendjet e të cilëve janë objektivisht të ndryshme përbën diskriminim në pasojë, njësoj si trajtimi i pabarabartë ndërmjet personave gjendjet e të cilëve janë objektivisht të njëjtë.

Neni 11 i **Liqjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi** parashikon se masa e përkohshme, e veçantë që synon pëershpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendor në nenin 1 të ligjit, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet apo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit Racial (CERD) në Rekomandimin e Përgjithshëm 32 “*Kuptimi dhe qëllimi i masave të veçanta në Konventën Ndërkombëtare Për Eleminimin e Diskriminimit Racial*”, ka sqaruar imtësisht kuptimin dhe fushën e veprimit të masave të veçanta në kuadër të Konventës për Eleminimin e Diskriminimit Racial. Sipas CERD, koncepti i masave të veçanta ose veprimeve pozitive bazohet në parimin se ligjet, politikat dhe praktikat e miratuara dhe të zbatuara në mënyrë që të përbushin detyrimet sipas Konventës kundër Diskriminimit Racor, kërkojnë që të merren masa shtesë sipas rrëthanave, përmes adoptimit të masave të veçanta të hartuara për t’i siguruar grupeve të paavantazhuara gëzimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore⁸.

“**Masat**” ose veprimet përfshijnë gjithë instrumentet legjislativ, ekzekutiv, administrativ, buxhetor dhe rregullator, në çdo nivel të aparatit shtetëror, si edhe planet, politikat, programet dhe regjimet preferenciale në fusha si punësimi, **strehimi**, arsimi, kultura dhe pjesëmarrja në

⁸ CERD, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 32, para 11.

jetën publike për grupet e pafavorizuara⁹. Zbatimi i parimit të mosdiskriminimit kërkon që karakteristikat e grupit të merren parasysh.¹⁰

Sipas **Komititetit për Eleminimin e Diskriminimit Racial**, koncepti i masave të veçanta ose veprimeve pozitive bazohet në parimin se ligjet, politikat dhe praktikat e miratuara dhe të zbatuara në mënyrë që të përbushin detyrimet sipas Konventës kundër Diskriminimit Racor, kërkojnë që të merren masa shtesë sipas rrëthanave, përmes adoptimit të masave të veçanta të hartuara për t'i siguruar grupeve të paavantazhuara gjëzimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore¹¹.

Pra, veprimet pozitive jo vetëm që nuk janë një përjashtim nga parimi i mos-diskriminimit, por janë pjesë integrale e kuptimit dhe janë thelbësore për eleminimin e diskriminimit racor dhe përparimin e dinjitetit njerëzor dhe barazisë efektive¹².

Po ashtu, **Direktivat e BE-së** për mosdiskriminimin shprehimisht parashikojnë mundësinë e marrjes së veprimeve pozitive duke parashikuar se me qëllim arritjen e barazisë së plotë në praktikë, parimi i trajtimit të barabartë nuk pengon ndonjë shtet anëtar që të mbajë apo miratojë masa të veçanta për të parandaluar apo kompensuar dizavantazhet që lidhen me një shkak të mbrojtur¹³.

- Praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)

GjEDNJ është shprehur se “e drejta për të mos u diskriminuar në gjëzimin e të drejtave të garantuara nga Konventa shkelet edhe kur shtetet dështojnë të trajtojnë ndryshe personat të cilët ndodhen në situate të ndryshme në mënyrë të rëndësishme¹⁴”.

Në çështjen **Yordanova dhe të Tjerët v. Bullgarisë¹⁵**, GJEDNJ-ja konsideroi se, ishte e ligjshme për autoritetet, për qëllime të zhvillimit urban, të përpinqeshin të rifitonin tokën nga njerëz që e kishin zënë atë në mënyrë të paligjshme. Nuk kishte dyshim se autoritetet, në parim, kishin të drejtë të largonin kërkuesit, të cilit kishin zënë një truall bashkiak pa leje. Megjithatë, për shumë dekada autoritetet në parim kishin toleruar vendbanimet e paligjshme të romëve. Ata i kishin lejuar ata që të zhvillonin lidhje të forta me vendin dhe të ndërtonin aty një jetë në

⁹ CERD, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 32, para 13.

¹⁰ CERD, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 32, para 8.

¹¹ CERD, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 32, para 11.

¹² CERD, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 32, para 10-20.

¹³ Direktiva e Barazisë Raciale, Neni 5; Direktiva e barazisë në Punësim, Neni 7; Direktiva për Barazi në fushën e të mirave dhe shërbimeve; neni 6; Direktiva e Barazisë Gjinore, neni 3.

¹⁴ GjEDNJ, Thlimmenos v. Greqisë; GjEDNJ, Pretty v. Mbretërisë së Bashkuar.

¹⁵ GjEDNJ, Yordanova dhe të tjerët v. Bullgarisë, vendim 24.04.2012.

komunitet. Gjykata vërejti se sipas Konventës nuk ekziston një detyrim për shtetet që të sigurojnë strehim për kërkuesit. Megjithatë, një detyrim për të siguruar strehim për individë veçanërisht vulnerabël mund të rrjedhë nga nenit 8, në raste të veçanta. Gjithashtu, para nxjerrjes së urdhrit të dëbimit, autoritetet nuk e kishin konsideruar rrezikun që kërkuesit do të bëhen në pastrehë dhe madje, kishin deklaruar që rreziku ishte i pa rëndësishëm. Gjykata gjithashtu theksoi se në kontekstin e nenit 8, veçori është e kërkuesve si një grup social i pavantazhuar, si dhe nevojat e tyre specifike, duhet të konsideroheshin në këndvështrimin e vlerësimit proporcional, të cilin autoritetet ishin të detyruar ta kryen, por që nuk ishte bërë. Gjykata vlerësoi se urdhri i dëbimit ishte i bazuar në ligj, por që procedurat për nxjerrjen e këtij urdhri nuk kërkonin që urdhri të ishte proporcional me qëllimin që synonte të arrinte. Prandaj do të kishte një shkelje të nenit 8, nëse urdhri do të zbatohet. Gjykata u shpreh se nuk ngrihej ndonjë çështje e veçantë sipas nenit 14 dhe se ishte e panevojshme që të shqyrtonte veçmas këtë pretendim të kërkuesve.

Në çështjen *Connors v. Mbretërisë së Bashkuar*¹⁶, GJEDNJ-ja, vlerësoi se pozita vulnerabël e romëve si pakicë do të thotë që nevojave të tyre dhe stilit të ndryshëm të jetesës duhej t'i jepej konsideratë e veçantë, si në aspektin rregullator, ashtu edhe në marrjen e vendimeve për raste specifike. Kështu, autoritete britanike kishin një detyrim pozitiv që të lehtësonin mënyrën e jetesës së romëve.

Në çështjen *Bagdonavicius dhe të Tjerët v. Rusicë*¹⁷, gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare dhe të shtëpisë) të Konventës, duke konstatuar se ankuesit, në procedurat lidhur me prishjen e shtëpive të tyre, nuk kishin përfituar nga shqyrtimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes, dhe se autoritetet kombëtare nuk kishin kryer konsultime të vërteta para dëbimit të tyre me forcë, lidhur me mundësitë e mundshme të zhvendosjes, në bazë të nevojave të tyre.

Në çështjen *Winterstein dhe të Tjerët v. Francës*¹⁸, Gjykata theksoi, se në shumë instrumente ndërkomëtare dhe të Këshillit të Evropës theksojnë nevojën, që në rastet e dëbimit me forcë të romëve ose udhëtarëve, personave t'u ofrohet strehim alternativ. Autoritetet kombëtare duhet të merrnin parasysh faktin kur person i përkasin një pakice vulnerabël; kjo nënkupton faktin se i duhet kushtuar vëmendje e posaçme nevojave të tyre dhe mënyrës së tyre të ndryshme të jetës kur është fjala për të hartuar zgjidhje për zaptimin e paligjshëm të tokës ose për të vendosur mbi strehimin alternativ të mundshëm .

- *Masat positive / masat e veçanta sipas akteve ndërkomëtare*

¹⁶ GjEDNJ, Connors v. Mbretërisë së Bashkuar, vendim datë 27.05.2004.

¹⁷ GjEDNJ, Bagdonavicius dhe të Tjerët v. Rusicë, vendim datë 11.10.2016.

¹⁸ GjEDNJ, Winterstein dhe të Tjerët v. Francës, vendim datë 17.10.2013.

Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit Racial, në Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 27, *Mbi diskriminimin ndaj romëve*, CERD ka vërejtur marrjen e masave të veçanta sipas fushave dhe ndër të tjera me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës, shtetet duhet të marrin veprime pozitive të tilla si:

- *Të zhvillojë dhe zbatojë politika dhe projekte të cilat synojnë mënjanimin e vecimit të komuniteteve rome sa i takon strehimit; të përfshijë komunitetet dhe shoqatat rome si partnerë bashkë me të tjerët në projekte për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e shtëpisë.*
- *Të veprojë me vendosmëri kundër çdo praktike diskriminuese që prek romët, kryesisht nga autoritetet lokale dhe pronarë privatë, për të marrë banesë dhe mundësi strehimi; të veprojë me vendosmëri ndaj çdo mase që i mohon banesën ose dëbimin e paligjshëm të romëve dhe të mos i vendosin romët në kampe, në zona të cilat janë të izoluara dhe pa mundësi aksesi në shërbimet shëndetësore dhe lehtësira të tjera.*

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), në Rekomandimin Nr. 13 *Për Luftën Kundër Anti-Ciganizmit Dhe Diskriminimin Kundër Romëve*, miratuar më datë 24 qershor 2011¹⁹, kërkohet nga shtete që të luftojnë anti-ciganizmin në lidhje me strehimin dhe të drejtën për respektimin e shtëpisë së tyre, dhe përkatësisht:

- *t'u ofrojnë mundësi romëve të kenë strehim të denjë;*
 - *të luftojnë ndarjen de facto, ose të detyruar lidhur me strehimin;*
 - *të sigurojnë se ofrimi i shtëpisë sociale për romët u vjen në ndihmë integrimit të tyre dhe të mos i mbajë ata të ndarë;*
 - *të sigurojnë që romët nuk dëbohen pa njoftim paraprak dhe pa iu dhënë atyre mundësinë e një strehimi tjetër me kushte të denja;*
 - *të marrin hapa për të legalizuar zaptimin e trojeve ose banesave të romëve që kanë shkelur rregullat e planifikimit urban, pasi situata është toleruar për një periudhë të gjatë kohe nga organet publike;*
- **Problematikat e strehimit të komunitetit rom dhe egjiptian**

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga **Komisioneri**, është konstatuar se kushtet e jetesës dhe strehimi i familjeve që i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian vazhdojnë të jenë të vështira dhe ky komunitet vazhdon të jetë një komunitet i margjinalizuar i shoqërisë.

Problematika e strehimit dhe kushteve të jetesës së komunitetit rom dhe egjiptian është konstatuar edhe nga organizma të ndryshëm ndërkombëtarë, të cilët në vazhdimësi i kërkojnë

¹⁹ Rekomandimi sqaron se termi “romë” përfshin jo vetëm romët, por edhe sintit, kalit, ashkalinjtë, egjiptianët, monushët, dhe grupe të tilla të ngjashme popullsish, së bashku me endacakët, në mënyrë që të përqafohen diversiteti i madh i grupeve në fjalë.

qeverisë që të marrë masa për të përmirësuar kushtet e strehimit dhe jetesën e këtij komuniteti, si më poshtë:

Në raportin e ECRI-it për Shqipërinë – viti 2015, (cikli i pestë monitorues), ECRI thekson gjetjet e mëparshme, që, me përjashtim të pak shembujve pozitivë, politika aktuale e strehimit social, pavarësisht objektivave ambiciozë, nuk mund të zgjedhë situatën e strehimit ligjshmërisht të pasigurt të komuniteteve rome dhe egjiptiane. Për pasojë, gjendja aktuale i izolon dhe më tej këto komunitete nga pjesa tjeter e popullsisë, duke e bërë më të vështirë integrimin e tyre.²⁰

ECRI, ka rekomanduar autoritetet shqiptare, që të sigurojnë që të gjithë romët, si dhe personat e tjerë që mund të dëbohen prej shtëpive të tyre, të gëzojnë të gjitha garancitë e parashikuara nga tekstet ndërkombëtare në këtë kuadër; ata duhet të njoftohen paraprakisht për dëbimin e planifikuar dhe të përfitojnë nga mbrojtja e përshtatshme ligjore; ata nuk duhet të dëbohen pa mundësinë e ristrehimit në akomodim të përshtatshëm²¹.

Raporti i Progresit për vitin 2018 për Shqipërinë, i Komisionit Evropian, i rekomandon Shqipërisë që të gjejë një zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme në lidhje me strehimin, në veçanti për romët dhe egjiptianët.

Me VKM Nr.1072, datë 23.12.2015, qeveria ka miratuar **Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020**. Në këtë dokument janë adresuar prioritetet për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetin rom dhe atë egjiptian.

Me VKM nr. 405, datë 01.06.2016, qeveria ka miratuar **Strategjinë e Strehimit Social 2016-2020**. Në këtë dokument është adresuar si prioritet përmirësimin e situatës së strehimit për familjet e pafavorizuara ku përfshihen edhe familjet rome dhe egjiptiane. Strategjia synon që brenda periudhës kohore 2016-2020, të bëhet rishikimi i legislacionit për për të mundësuar strehimin e familjeve që nuk përfitojnë nga shpronësimet publike, për të garantuar strehimin e 100% të familjeve të dëbuara me forcë sa herë paraqiten raste të tilla.

Në të dy dokumentet e mësipërme strategikë, qeveria ka adresuar çështjet e strehimit të komunitetit romë dhe egjiptian, në vijim të problematikave të konstatuara dhe të pranuara prej saj, referuar analizës së situatës aktuale të strehimit që bëhet në këto dy dokumenta.

²⁰ Raporti i ECRI-it për Shqipërinë – viti 2015, (cikli i pestë monitorues), miratuar më 15 mars 2015, botuar më 09 qershor 2015, faqe 29-30.

²¹ Raporti i ECRI-it për Shqipërinë – viti 2015, (cikli i pestë monitorues), miratuar më 15 mars 2015, botuar më 09 qershor 2015, faqe 28.

Në këtë Plani Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, por edhe gjatë vendimarrjes së Komisionerit, vendimit nr. 114, datë datë 22.06.2016, është pranuar se për strehimi i familjeve rome banesat e të cilëve nga ndërtimi i rrugës ‘’Unaza e madhe e Tiranës’’, familje të cilat nuk përfitonin nga shpronësimet, trajtimi sipas VKM nr. 230, datë 13.5.2015, u konsiderua si një zgjidhje emergjente. Pra, edhe vetë autoritetet pranojnë se zgjidhja e dhenë sipas kësaj VKM nuk zgjidh në mënyrë të qëndrueshme strehimin e këtyre familjeve të cilat ngelën të pastreha. Referuar vendimit nr. 114 të KMD-së, datë 22.06.2016, VKM nr. 230, datë 13.05.2015, qeveria duke i trajtuar të gjitha familjet që u preken nga investimi punlik njëlloj pa marrë parasysh kushtet e ndryshme sociale që mund të kishin familjet që i përkasin komunitetit rom dhe ati egjiptian, kishte dështuar që ti trajtonte ndryshe çështjen e strehimit të familjeve rome dhe egjiptiane nga çështja e strehimit për familjet e tjera jo rome. Pikërisht trajtimi i njëjtë i dy çështjeve të ndryshme, gjeneroi trajtimin dhe vendosjen në kushte më pak të favorshme familjet rome dhe egjiptiane.

- ***Nevoja për sigurimin e strehimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian.***

Aktualisht, sa pretendohet edhe nga familjet që kanë përcjellë ankesën pranë Komisionerit, rezulton se në bazë të VKM nr. 254, datë 09.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 58, datë 21.01.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin e disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”, me programe sociale të strehimit”, të ndryshuar, është vendosur që për familjet në Vlorë të cilat u prekën nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”, do të vijojë trajtimi me pagesë qiraje deri në sistemimin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin.

Nëse i bejmë një analizë VKM-së, Nr. 58, datë 21.1.2015, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 230, datë 13.05.2015, në lidhje me arsyet e miratimit të tyre, bazës ligjore ku janë bazuar dhe në ndryshimet mënyrë kronologjike që këto VKM kanë pësuar, rezulton se:

Së pari, të dy VKM-të e mësipërme janë miratuar për të mbështetur familjet të cilat posedonin ndërtimë pa leje, me funksion banimi, të cilat prekeshin nga zbatimi i dy projekteve publike respektive;

Së dyti, baza ligjore për miratimin e të dy VKM-ve të mësipërme, janë nenet 30 e 33, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar.

Së treti, të dy VKM-të janë miratuar dhe kanë pësuar ndryshime respektive pak a shumë në të njëjtën periudhë kohore.²²

²² VKM Nr. 230, datë 13.03.2015 ka pësuar këto ndryshime: VKM, Nr.694, datë 31.07.2015; VKM, Nr.314, datë 27.04.2016; VKM, Nr.552, datë 27.07.2016; VKM, Nr.261, datë 29.03.2017.

Sa më sipër, rezulton se situatat për të cilat janë miratuar aktet përkatëse nga Këshilli i Ministrave janë të situata të ngjashme. Por, ndërkohë që për familjet që janë prekur nga projekti “*Lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë*”, është parashikuar që do të vijojë trajtimi me pagesë qiraje deri në sistemimin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin, një gjë e tillë e tillë nuk është bërë për familjet që janë prekur nga projekti ‘*Unaza e madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës*’, ku edhe përfshihen familjet e komunitetit rom dhe atij egjiptian.

Në bazë të nenit 7, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi garantonhet, nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupei personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjtë ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjera ose grupe të tjera personash.

Sa më sipër është argumentuar dhe në mënyrë të veçantë mbi detyrimin që shteti ka për të marrë masa të veçanta, për të siguruar mbrojtjen nga diskriminimi të personave që i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian, mosveprimi i institucioneve përgjegjëse për të marrë masa për të siguruar një strehim të qëndrueshëm dhe afatgjatë për familjet rome dhe egjiptiane që kanë mbetur të pastreha për shkak të projekti “*Unaza e madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës*”, do të krijonte një situatë diskriminuese.

Sa më lart dhe bazuar në nenin 32, pika 1, gërmë “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, ku përcaktohet se Komisioneri ka kompetencë, t'u bëjë rekondime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues, Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi,

R E K O M A N D O N :

1. Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësive, për sigurimin e strehimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian, të cilat kanë mbetur të pastreha si rezultat i zbatimit të projektit “*Unaza e madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës*”.
2. Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësive, për të siguruar vazhdimin e trajtimit me pagesë qiraje deri në sistemimin

VKM Nr. 58, datë 21.1.2015 ka pësuar këto ndryshime: VKM nr.150, datë 19.2.2015; VKM nr. nr.64, datë 3.2.2017 dhe së fundi VKM nr.254, datë 9.5.2018.

me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin, të familjeve të cilat janë trajtuar në bazë të VKM nr. 230, datë 13.05.2015 “*Për trajtimin me pagesë të qirave për disa familje që preken nga zbatimi i projektit: Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës*”, të ndryshuar.

3. Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësive, për kordinimin dhe lehtësimin e procesit, si dhe mbledhjen e dokumentacionit të kerkuar për të aplikuar në programet që parashikon ligji për strehimin, për familjet të cilat janë trajtuar sipas VKM nr. 230, datë 13.05.2015, të ndryshuar, deri në sistemimin e tyre në një nga programet e strehimit të parashikuar nga ligji.

Lutemi përcjelljen e informacionit, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi dhe zgjidhjen e situatës apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.

